



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1314 Prot.

Vlorë më, 20.09. 2022

VENDIM

Nr. 27, datë 20.09.2022

PËR
MIRATIMIN E KARTËS SË AUDITIT

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13, nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", të Ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Urdhrit nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016", si dhe referuar shkresës të Sektorit të Auditit nr.1272 prot, datë 13.09.2022, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.09.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në kartën e auditit për Sektorin e Auditit të Brendshëm në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë sipas Urdhrit nr. 4, datë 10.01.2020.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sektorit i Auditit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë .
3. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi gjendet karta e Auditit me ndryshimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I AUDITIT

Nr. 1272 Prot

Vlorë, më 13.09.2022

Lënda : Zbatim I rekomandimit

BORDI ADMINISTRIMIT

KËTU


Në bazë të raportit përfundimtar të vlerësimit të jashtëm të cilësisë nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për Sektorin e Auditit ,është lënë rekomandimi për përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm,
Bashkelidhur po ju përcjellim Kartën e Auditit me shtesën e paragrafit sipas Urdhërit nr 4 datë 10.01.2020 :

Karta e Auditimit të Brendshëm është një dokument zyrtar i cili përcakton, autoritetin, dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm brenda njësisë publike, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësisë së auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi cdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit/Bordit Drejtues (në rastet kur një organ i tillë ekziston) dhe titullari i njësisë publike ka të drejtën për aprovimin përfundimtar të kartës së auditimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin !

Përgjegjës Sektori

Marjanthi Rrapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SEKTORI I AUDITIT

MISIONI

Misioni Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është :

Të ofrojë shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe keshilldhënëse të dizenuara që të shtojnë vlerën dhe përmirësojnë operacionet e organizatës;

Ushtimi i një metode të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit e rrezikut dhe kontrolleve të brendshme pranë njësive publike;

Të ndihmoje organizatën për të përmbushur objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes;

Të shtojë vlerën e veprimeve të subjekteve brenda fushës së përgjegjësisë dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrolleve të brendshme, të forta e të besueshme, që garantojnë mbrojtjen e pasurisë publike, duke siguruar cilësi me kosto të reduktuara;

T'i japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësive të sektorit publik në mënyrë të pavarur dhe objektive;

Të ofrojë shërbime këshillimi, për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në njësinë e sektorit publik;

Të sjellë përfitime në efciensën operationale, kontrolle të brendshme të forta dhe politika të përmirësuara.


Për të realizuar këtë mision, auditimi i brendshëm bazohet mbi një strategji të vlerësimit të rrishtit duke kryer auditime dhe paraqet raporte të pavarura për efektivitetin e kontrolleve të menaxhimit dhe performancën operationale të subjektit të audituar.

Fushëveprimi i punës së AB është që të përcaktoj nëse proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes të hartuara dhe paraqitura nga menaxhimi, janë adekuate dhe funksionon në atë mënyrë saqë garanton se:

Rreziqet identifikohen dhe menaxhohen në menyrën e duhur;

Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes ndodhë sipas nevojës dhe me efektivitet;

Informacioni financiar, menaxheriale dhe operational është i saktë, i besueshëm dhe në kohë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT

Aktivitetet dhe veprimet janë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme;

Burimet sigurohen me ekonomikitet, përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë adekuate;

Programet, planet dhe objektivat janë përmbushur;

Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm;

Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatore që kanë ndikim të puna e drejtorisë janë të njohura, trajtohen dhe adresohen siç duhet.


Neni 1

Objekt i Kartës së Auditimit të Brendshëm

Karta e Auditimit të Brendshëm është një dokument zyrtar i cili përcakton, autoritetin, dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm brenda njësisë publike, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësisë së auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit/Bordit Drejtues (në rastet kur një organ i tillë ekziston) dhe titullari i njësisë publike ka të drejtën për aprovimin përfundimtar të kartës së auditimit.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit Standard të auditimit të brendshëm.

Mundësitë për përmirësimin e kontrollit të menaxhimit, aftësisë përfituese dhe imazhit të njësisë mund të identifikohen gjatë auditimeve. Ato do të komunikohen te niveli i duhur i menaxhimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SEKTORI I AUDITIT

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik synon:

a) mbështetjen e njësisë publike për të arritur qëllimet e saj, duke:

ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike; vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, të strukturave, të vendimeve, të procedurave e të kontrolleve, pra, sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari I njësisë publike;
- përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;
- besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- kryerjen e veprimtarive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- ruajtjen e aseteve dhe të informacionit;
- përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike;

b) mbështetjen e angazhimeve/kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit **për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;**

c) mbështetjen e një angazhimi auditimi për shërbimet e sigurisë, që nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv për të dhënat nga audituesi I brendshëm, me qëllim që ai të japë një opinion ose përfundim të pavarur për një proces, një sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.

Objektivat dhe objekti për çdo angazhim/detyrë auditimi **për shërbimet e sigurisë** përcaktohet nga drejtuesi i auditimit të brendshëm. Një angazhim/detyrë auditimi kalon nëpër këto faza:

planifikimin;


kryerjen e kontrolleve;

raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra.

Një angazhim/detyrë auditimi **për shërbime konsultimi** ka për qëllim të shtojë vlerën dhe të përmirësojë qeverisjen e njësisë publike, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit, pa qenë e nevojshme që audituesi I brendshëm të marrë përsipër përgjegjësi menaxheriale. Një angazhim auditimi për shërbime konsultimi bëhet me nismën e titullarit të njësisë publike. Objekti dhe objektivat e çdo detyre përcaktohen nga programi I auditimit.

Puna e Auditimit të Brendshëm përfshin dhe drejtimet e mëposhteme :

Identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe rekomandon për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT

Vlerësimin e kontrolleve që trajtojnë riskun;

Nxitjen e kontrolleve efektive dhe efçente, dhe nismat për përmirësim të vazhdueshëm;

Vlerësimin dhe pasqyrimin e procesit që siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operacional.

Rekomandimin e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes për:

Promovimin e etikës dhe vlerave të duhura për organizatën;

Sigurimin e menaxhimit efektiv të performancës dhe përgjegjshmërisë së njësisë; dhe

Komunikimin efektiv për risqet dhe kontrollet në fushat përkatëse të njësisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 8, 12, 14 dhe 16 të Ligjit Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualit të Auditit të Brëndshëm si dhe Standarteve Ndërkombëtare për Praktikat Profesionale të Auditimit të Brëndshëm.

Neni 3

Statusi Organizativ


Njësia e auditimit të brendshëm (NjAB) është pjesë përbërëse e strukturës organizative të universitetit e pavarur nga ana organizative dhe kurdohere jashtë strukturave operative.

Kjo njësi ka varësi funksionale nga Bordi Administrimit.

Neni 4

Qëllimi i auditimit të brendshëm

Qëllimi i auditimit të brendshëm është të ndihmojë Universitetin "Ismail-Qemali" të arrijë objektivat dhe të përmbushë me efektivitet përgjegjësit e veta, duke përdorur një metodë sistematike dhe të disiplinuar, për të vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe përmirësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut e proceseve të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT**

Neni 5

Objekt i punës dhe veprimtaria e auditimit të brendshëm

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të kryhet në përputhje me :

- a. Standardet ndërkombërate të auditimit të brendshëm të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave,
- b. Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
- c. Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike.

Auditimi i brendshëm përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e aktiviteteve, operacioneve, proceseve, politikave, procedurave dhe sistemeve për të siguruar :

- a) besueshmëri dhe integritet të informacionit;
- b) pajtueshmëri me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregullat;
- c) ruajtje të aktiveve;
- d) përdorim ekonomik dhe efikas të burimeve;
- e) përmbushje të objektivave dhe qëllimeve të vendosura në lidhje me veprimtaritë ose programet e Universitetit.

Neni 6

Autoriteti

1. Audituesi i brendshëm, në përmbushje të përgjegjësive të veta, autorizohet:


- a. Të shqyrtojë të gjitha veprimtaritë dhe informacionet e Universitetit;
- b. Të ketë të drejta hyrjeje dhe përdorimi të plotë tek të gjitha veprimtaritë, regjistrimet, informacionet, sistemet dhe pronat.
- c. Të shpërndajë burimet, të vendosë mbi shpeshësinë, të përzgjedh temat, të përcaktojë objektin e punës dhe të zbatoj teknikën e kërkuesit për të realizuar objektivat, në mënyrë të pavarur;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT**

- d. Të ushtrojë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapsirë për ndërhyrje nga kolegët dhe mbikëqyrësit, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit.
 - e. Të ruaj konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo lidhur me të, si dhe të ruaj dokumentet për cdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
 - f. Të marrin nga punonjësit, për rastet që gjykohen të nevojshme shpjegime, deklarat dhe fotokopje të dokumenteve të cilat kanë lidhje me auditimin e brendshëm
 - g. Të paraqesë kërkesën për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi kur çmojnë se për shkakë të argumentuara çënohet besueshmëria dhe cilësia e auditimit.
2. Audituesi i brendshëm njofton menjëherë Titullarin për përpjekjet për të fshehur ose mbajtur informacionin e kërkuar ose për ta penguar atë në ushtrimin e përgjegjësive të veta.
3. **Audituesi i brendshëm, në ushtrimin e përgjegjësive të veta, nuk autorizohet:**
- a. Të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të Universitetit, përveç veprimtarisë audituese;
 - b. Të jenë përgjegjës për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja;
 - c. Të vijë në ndihmë në cdo lloj forme punonjësve të tjerë për përgjegjësitë që iu janë ngarkuar atyre;
 - d. Të auditojnë veprime ose operacione, për të cilat kanë qenë përgjegjës në 12 muajt e fundit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT

Neni 7

Pavarësia dhe objektiviteti

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe audituesit e brendshëm duhet të jenë objektiv në përmbushjen e detyrave të tyre.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm është e pavarur nga pikëpamja **funksionale dhe organizative**.

Funksioni i auditimit të brendshëm ka status të pavarur brenda subjektit në dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve.

Pavarësia Funktionale, nënkupton që veprimtaria e auditimit të brendshëm (struktura e AB/ Audituesit) duhet :

Të kryejnë misionin e tij në mënyrë të pavarur që në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve dhe rekomandimeve të auditimit nga subjekti që auditohet. Kryerja e auditimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator, Standardeve dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë njësisë.

Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit

· Të japin gjykime të paaneshme dhe të drejtëpërdrejta që janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm.

· Të jenë funksionalisht përgjegjës mbi baza të përherëshme.

Të mos ketë detyra, kompetenca, autoritet, funksione dhe përgjegjësi të tjera përveç atyre që lidhen me menaxhimin e funksionit të auditimit të brendshëm.

· Të mos jetë e lidhur me zbatimin ,zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja por mund të japin këshillime para dhe pas zhvillimeve të tilla.

Pavarësia Organizative, nënkupton që veprimtaria e auditimit të brendshëm / Audituesit duhet :

Të raportojnë te Drejtori i DAB dhe nëpërmjet tij, raportohet drejtëpërdrejtë tek Titullari i njësisë , si niveli më i lartë i drejtimit

Të jenë të lirë nga ndërhyrjet në përcaktimin e objektit të auditimit, kryerjen e misionit dhe komunikimin e rezultateve,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT

Të mos angazhohen dhe të mos përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera brenda organizatës të cilat nuk lidhen me funksionimin e Auditimit të Brendshëm.


Të mbajnë qëndrim të paanshëm, qëndrim jo-tendecioz dhe të shmangin konfliktin e interesit.

Neni 8

Përgjegjësia

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

- a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- d) të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- e) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për cdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- f) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- g) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;
- h) të raportojnë menjëherë te drejtuesi i njësisë së auditimit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I AUDITIT**

**Neni 9
Raportimi**

Njësia e auditimit të brendshëm do të raportojë periodikisht tek Rektori Universitetit "Ismael Qemali" mbi veprimtarinë e njësisë, qëllimin, autoritetin, përgjegjësitë dhe performancën e saj. Raportimi do të përfshijë ekspozimet ndaj rreziqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe rreziqet e mashtrimit si dhe çështje të tjera të nevojshme.

**Neni 10
Standardet e praktikave të auditimit**

Veprimtaria e auditimit të brendshëm zhvillohet në pajtim me Standardet ndërkombëtare të shpallura nga Instituti Audituesve të Brendshëm "Për praktikatat Profesionale të Auditimit të Brëndshëm"

Rregullat dhe metodologjinë e auditimit (procedurat për planifikimin, kryerjen, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi) të përcaktuara në Manulain e Auditimit të Brëndshëm.

Kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit e Sektorit Publik, miratuar nga Ministri i Financave (Urdhëri nr 86, datë 10.12.2015) dhe rregullave të sjelljes në administratën publike

**Neni 11
Hyrja në fuqi**

Kjo kartë do të shqyrtohet dhe rishikohet sa herë lind nevoja mbi bazë të propozimeve të Drejtuesit të njësisë së AB.Cdo ndryshim substancialë do të miratohet zyrtarisht nga Bordi Admnistrimit.

Kjo kartë është në fuqi që nga data e miratimit të saj.